

Memorandum i Mirëkuptimit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / B.	427/18
Nr. i fq. / Br. sht.	2
Data / Datum:	29.03.2018
VUSHTRRI - VUČITRN	

Në mes

OJQ PEN (Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë)

Dhe

Komunës së Vushtrrisë

Ky Memorandum i Mirëkuptimi ("MiM") është ndërmjet OJQ PEN (Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë), tutje "PEN", Rruga Rexhep Mala nr. 5A, Prishtinë, Kosovë, si partner implementues i programit të Kombeve të Bashkuar i Fondit të Fëmijëve ("UNICEF"), projekti: *Ngritja e agentëve të ndryshimit: Inovacion për të rinjë dhe fuqizimi i adoleshentëve*, iniciativë e Laboratorit të Inovacioneve të UNICEF-it në Kosovë,

Ku, PEN dhe Komuna e Vushtrrisë do të bashkëpunojnë në mbështetjen e të rinjve në Kosovë, më saktësisht implementimin e kampanjës "*United4Handikos*": Kampanjë kjo e financuar nga UNICEF Innovations Lab Kosovo, e cila për qëllim ka renovimin e qendrës për persona me nevoja të veçanta. Qendër kjo, e cila është e ndërtuar në komunën e Vushtrrisë, por në mungesë buxheti nuk ka mjetet e duhura për ushtrimet primare të cilat ndihmojnë anëtarët e Handikos në zhvillimin e tyre psikik dhe atë fizik.

Në emër të marrëveshjes, palët pajtohen që Komuna e Vushtrrisë e ndihmon implementimin e kampanjës në këto fusha ose aspekte:

- Ofron ndihme dhe mbështetje sipas kërkeses se grupit implementues te kampanjës së planifikuar, duke pasur parasysh iniciativën e tyre për të ndihmuar Komunën në funksionalizimin e qendrës së Handikos në Vushtrri, duke u fokusuar specifikisht në renovimin e qendrës e cila do të ndihmonte në zhvillimin fizik dhe atë psikik të anëtarëve të regjistruar në këtë qendër;
- Ofron lokacionin për mbajtjen e koncertit humanitar të organizuar nga grupi implementues, i cili ka për qëllim mbledhjen e fondeve për të renovuar qendrën e Handikos;
- Siguron dhe ofron përkrahje në kompletimin e renovimit të sallave të qendrës së Handikos, kjo duke u pajtuar nga të dy palët dhe duke u bazuar në mundësitë se çfarë komuna do të mund të ofroj, financiarisht apo në mënyra të tjera;
- Siguron që drejtoritë përkatëse të jenë të informuar rreth kampanjës "*United4Handikos*" dhe të ndihmojnë në rritjen e vetëdijësimit ndaj çështjes së rëndësishme së një qendre të renovuar që ndihmon personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin e tyre shëndetësor, por jo vetëm.

Përderisa, OJQ PEN përmbush këto obligime ndaj kësaj iniciative të organizuar nga të rinjt e komunës së Vushtrrisë:

- Mbështetje financiare në shumën prej 500€(euro) për organizimin e koncertit dhe implementimin e kampanjës **“United4Handikos”** i dedikuar për mbështetje të Handikos në Vushtrri;
- Ofron mentorim dhe mbështetje për zhvillimin e kampanjës dhe procedurat e implementimit të kampanjës së lartëpërmendur;
- Ofron trajnim për antarët e grupit **“United4Handikos”** rreth procedurave dhe rregullave financiare dhe ato administrative gjatë implementimit të kampanjës;
- Siguron raportimin dhe dokumentimin e çdo aktiviteti të implementuar gjatë kampanjës **“United4Handikos”**;
- Siguron që në çdo material të vizibilitetit të ketë të përfshirë komunën e Vushtrrisë si mbështetes në perakrahen ndaj zhvillimit të komunës së Vushtrrisë;
- Siguron që në çdo prezantim medial të kampanjës të jetë e përfshirë edhe komuna e Vushtrrisë si partner implementues i kampanjës **“United4Handikos”**.

Kohëzgjatja e MiM

Ky MiM do të zgjasë për një periudhë tre (3) mujore përgjatë gjithë procesit të implementimit të kampanjës së selektuar.

Ndërprerja e MiM

Në rastet kur njëra palë dëshiron të ndërpresë këtë memorandum, njoftimi duhet të bëhet të paktën dy (2) javë më herët dhe në mënyrë të shkruar.


Bujar Fejzullahu



Drejtor Ekzekutiv

OJQ - PEN

Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës, Vushtrri

Data: 29.03.2018